



Viti i XV-të I Botimit, Nr.1,

Qershor 2023

MENAXHIMI I SITUATËS POST COVID-19 NËN NDIKIMET NIVELEVE TË ANKTHIT E TË PRIRJEVE TË LOKUSIT TË KONTROLLIT TEK STUDENTËT E DEGËVE TË MËSUESISË TË FALULTETIT TË SHKENCAVE TË EDUKIMIT NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS

Arben Hoti *, Elisabeta Kafia**

Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme

Përmbledhje

Menaxhimi i situatës post Covid-19 u shoqërua me ndikime të faktorëve të ndryshëm, që përfshiu dhe faktort psikologjikë me ndikime të ndryshme të tyre.

Ankthi, nivelet e stresit, shfaqjet e simptoma të stresit post traumës, të fobive dhe të depresionit janë disa prej faktorëve psikologjikë ndikues që normalisht ekspozohen edhe në një situatë të tillë shëndetësore kërcënuese.

Në këtë punim modest kërkimor eksplorues ne përpiqemi të japim një ndikim të menaxhimit të situatës post covid-19 nën ndikimin e ankthit dhe prirjes së lokusit të kontrollit që kanë studentët pjesë e një kampioni prej 85 studentësh.

Të dhënat empirike të nmarra nga instrumenti vlerësues i përdorur që paraqiten na japin mundësi e një analize përshkruese të prirjes së lokusit të kontrollit në menaxhimin e përvojës së tyre lidhur me covid-19.

Fjalë çelës: covid-19, student, ankth, lokus kontrolli, lokus kontrolli i jashtëm, lokus kontrolli i brendshëm, vaksinim

MANAGEMENT OF POST-COVID-19 SITUATION UNDER TENDENCY OF THE LOCUS OF CONTROL AMONG STUDENTS AT THE FACULTY OF EDUCATION SCIENCES IN SHKODER UNIVERSITY

Abstract

The management of the post-Covid-19 situation was accompanied by the impact of various factors, including psychological factors with their various impacts.

Anxiety, stress levels, symptoms of post-traumatic stress, phobias and depression are some of the influencing psychological factors that are normally exposed even in such a threatening health situation.

In this modest exploratory research paper we try to give an impact of managing the post covid-19 situa

tion under the influence of the tendency of anxiety and locus of control that students have part of a sample of about 85 students.

The empirical data obtained from the used assessment instrument that is presented allows us a descriptive analysis of the tendency of the locus of control in the management of their experience related to covid-19.

Keywords: *covid-19, student, anxiety, locus of control, external locus of control, internal locus of control, vaccination*

Hyrje

Ky artikull paraqet kontributin tonë realizuar mbi menaxhimin e periudhës postcovid tek studentët. Ai tregon një pjesë të marrë nga studimi i bërë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në fakultetet e Shkencave të Edukimit, të Shkencave të Natyrës dhe atij Ekonomik, me studentë të nivelit Bachelor.

Theksojmë se punimi kërkimor ka përfshirë vetëm studentë të degëve të Mësuesisë si një interesim i përbashkët kërkimor i yni.

Impakti i periudhës së covid-19 në shoqërinë njerëzore përfshirë edhe atë shqiptare ka shfaqur ndikime shumëplanëshe, edhe në aspektin psikologjik. Roli i aspekteve psikologjike në përballimin e situatës covid-19 dhe menaxhimi i tij në efektin e tyre tek rinia studentore universitare përbën një tjetër arsye madhore për të paraqitur këtë kontribut kërkimor.

Qëllimi kryesor i punimit është për të analizuar menaxhimin postcovid të studentëve të degëve të Mësuesisë në ndikimin e ankthit dhe të lokusit të kontrollit. Qëllim tjetër e punimit është për të marrë të dhëna empirike mbi prekjen nga covid-19, mënyrën e trajtimit të tij dhe herët e vaksinimit të studentëve të përfshirë në kampionin tonë. Një qëllim i tretë i punimit është të verifikojë lidhjen midis nivelit të ankthit me herët e vaksinimit dhe të mënyrës së trajtimit të covid-19 me prirjen e lokusit të kontrollit të individit.

Punimi iu referohet realizimit të qëllimeve duke përcaktuar objektiva të qartë si:

- sqarimet e nevojshme të literaturës mbi covid-19, ankthin, lokusin e kontrollit etj;
- përcaktimi metodologjisë së saktë mbi atë që synon punimi (përzgjedhja e kampionit, përcaktimi i instrumentit të vlerësimit etj, teknika metodologjike);
- administrimi dhe përpunimi i të dhënave empirike;
- nxjerrja e rezultateve;
- interpretimi dhe analizimi i rezultateve;
- publikimi i të dhënave kërkimore;

Përshtatur me qëllimet dhe objektivat e tij kemi ngritur 6 pyetje kërkimore të cilat janë:

1. Si shfaqet prekja nga covid-19 tek studentët e kampionit tonë?
2. Cila është mënyra e trajtimit të bërë nga prekja e covid-19?
3. Cila është situata e vaksinimit tek studentët e kampionit tonë?
4. Si shfaqen variablat ankth dhe lokus kontrolli?
5. A ndikojnë nivelet e ankthit në herët e vaksinimit?
6. A ka lidhje lokusi i kontrollit me mënyrën e trajtimit të covid-19?

Në përfundim të hyrjes theksojmë se punimi i referohet një strukture të qartë dhe se e gjithë puna është bërë duke ndjekur korrektësisht të gjitha pikat etike të nevojshme.

Mbi literaturën

Ankthi është një emocion i karakterizuar nga ndjenja tensioni, mendime të shqetësuara dhe ndryshime fizike si rritja e presionit të gjakut (APA, fq 66).

Njerëzit me çrregullime ankthi zakonisht kanë mendime ose shqetësime të përsëritura ndërhyrëse. Ata mund të shmangin situata të caktuara nga shqetësimi. Ata gjithashtu mund të kenë simptoma fizike si djersitje, dridhje, marramendje ose rrahje të shpejta të zemrës.

Ankthi nuk është i njëjtë me frikën, por ato shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë. Ankthi konsiderohet një përgjigje e orientuar drejt së ardhmes, me veprim të gjatë, e fokusuar gjerësisht në një kërcënim të përhapur, ndërsa frika është një përgjigje e përshtatshme, e orientuar drejt së tashmes dhe jetëshkurtër ndaj një kërcënimi qartësisht të identifikueshëm dhe specifik (Hoti V, & Hoti. A, 2022).

Ankthi konsiderohet një përgjigje e orientuar drejt së ardhmes, me veprim të gjatë, e fokusuar gjerësisht në një kërcënim të përhapur, ndërsa frika është një përgjigje e përshtatshme, e orientuar drejt së tashmes dhe jetëshkurtër ndaj një kërcënimi qartësisht të identifikueshëm dhe specifik. - mbiemër ankthioz.

Lokusi i kontrollit

Lokusi i kontrollit tregon vendin nga ky nisen njerëzit që ti vlerësojnë zhvillimet e ndodhive dhe ngjarjeve të jetës së tyre, vetes apo ndikimeve të jashtme. (Fjalori APA, fq, 608).

Individët me një lokus të fortë të brendshëm kontrolli besojnë se çdo veprim ka pasoja dhe se rezultatet e veprimeve të tyre pasqyrojnë aftësitë e tyre dhe mënyrën se si ata veprojnë në botë. Ata besojnë se ngjarjet që u ndodhin janë pasojë e zgjedhjeve dhe veprimeve të tyre, pavarësisht nëse zgjedhin apo jo të kenë kontroll mbi to.

Individët me lokus të madh kontrolli të jashtëm interpretojnë ngjarjet në jetën e tyre si të ndikuar jo nga veprimet ose aftësitë e tyre, por nga rrethanat jashtë kontrollit të tyre. Individët me një lokus të fortë të jashtëm kontrolli mbështeten në koncepte si “fati” dhe rastësia për të përshtatur përvojat e tyre. Në të njëjtën mënyrë, ndërsa disa rrethana janë ndoshta përtej aftësisë së shumicës së njerëzve për të ditur ose kontrolluar, rrethanat e tjera janë brenda mundësive tona për të ndikuar.

Në realitet, për shumicën e njerëzve, një përzierje e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm ndikojnë në bindjet për ngjarjet që ndikojnë në rrjedhën e jetës, në varësi të shëndetit të tyre dhe problemeve të shëndetit mendor dhe rrethanave të tyre socio-ekonomike. Të tillë “dy lokusat” mund të jenë më të aftë për të menaxhuar stresin sesa individët në të dy skajet e lokusit, sepse ata bëjnë zgjedhje proaktive ndërsa vazhdojnë të mbështeten në ndihmën e të tjerëve.

Lokusi i kontrollit shëndetësor ka të bëjë me mënyrën se si individët mendojnë dhe reagojnë ndaj vendimeve të tyre për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor. Gjetjet e shumë studimeve mbështesin që një lokus i brendshëm kontrolli lidhet pozitivisht me përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor dhe cilësisë së jetës

Mbi literaturën

Ankthi është një emocion i karakterizuar nga ndjenja tensioni, mendime të shqetësuara dhe ndryshime fizike si rritja e presionit të gjakut (APA, fq 66).

Njerëzit me çrregullime ankthi zakonisht kanë mendime ose shqetësime të përsëritura ndërhyrëse. Ata mund të shmangin situata të caktuara nga shqetësimi. Ata gjithashtu mund të kenë simptoma fizike si djersitje, dridhje, marramendje ose rrahje të shpejta të zemrës.

Ankthi nuk është i njëjtë me frikën, por ato shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë. Ankthi konsiderohet një përgjigje e orientuar drejt së ardhmes, me veprim të gjatë, e fokusuar gjerësisht në një kërcënim të përhapur, ndërsa frika është një përgjigje e përshtatshme, e orientuar drejt së tashmes dhe jetëshkurtër ndaj një kërcënimi qartësisht të identifikueshëm dhe specifik (Hoti V, & Hoti. A, 2022).

Ankthi konsiderohet një përgjigje e orientuar drejt së ardhmes, me veprim të gjatë, e fokusuar gjerësisht në një kërcënim të përhapur, ndërsa frika është një përgjigje e përshtatshme, e orientuar drejt së tashmes dhe jetëshkurtër ndaj një kërcënimi qartësisht të identifikueshëm dhe specifik. - mbiemër ankthioz.

Lokusi i kontrollit

Lokusi i kontrollit tregon vendin nga ky nisen njerëzit që ti vlerësojnë zhvillimet e ndodhive dhe ngjarjeve të jetës së tyre, vetes apo ndikimeve të jashtme. (Fjalori APA, fq, 608).

Individët me një lokus të fortë të brendshëm kontrolli besojnë se çdo veprim ka pasoja dhe se rezultatet e veprimeve të tyre pasqyrojnë aftësitë e tyre dhe mënyrën se si ata veprojnë në botë. Ata besojnë se ngjarjet që u ndodhin janë pasojë e zgjedhjeve dhe veprimeve të tyre, pavarësisht nëse zgjedhin apo jo të kenë kontroll mbi to.

Individët me lokus të madh kontrolli të jashtëm interpretojnë ngjarjet në jetën e tyre si të ndikuar jo nga veprimet ose aftësitë e tyre, por nga rrethanat jashtë kontrollit të tyre. Individët me një lokus të fortë të jashtëm kontrolli mbështeten në koncepte si “fati” dhe rastësia për të përshtatur përvojat e tyre. Në të njëjtën mënyrë, ndërsa disa rrethana janë ndoshta përtej aftësisë së shumicës së njerëzve për të ditur ose kontrolluar, rrethanat e tjera janë brenda mundësive tona për të ndikuar.

Në realitet, për shumicën e njerëzve, një përzierje e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm ndikojnë në bindjet për ngjarjet që ndikojnë në rrjedhën e jetës, në varësi të shëndetit të tyre dhe problemeve të shëndetit mendor dhe rrethanave të tyre socio-ekonomike. Të tillë “dy lokusat” mund të jenë më të aftë për të menaxhuar stresin sesa individët në të dy skajet e lokusit, sepse ata bëjnë zgjedhje proaktive ndërsa vazhdojnë të mbështeten në ndihmën e të tjerëve.

Lokusi i kontrollit shëndetësor ka të bëjë me mënyrën se si individët mendojnë dhe reagojnë ndaj vendimeve të tyre për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor. Gjetjet e shumë studimeve mbështesin që një lokus i brendshëm kontrolli lidhet pozitivisht me përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor dhe cilësisë së jetës (Maltby, Day dhe Macaskill 2017).

Studime mbi ndikimin e variablave tek Covid-19

Gjatë covid-19 u shfaqën ndikime në ankthin e njerëzve, e pasqyruar kjo në shumë studime. Një rishikim sistematik cilësor u krye për të hetuar prevalencën dhe lidhjen e ankthit në popullata të ndryshme të mostrës në lidhje me pandeminë COVID-19. Rezultatet e këtij rishikimi sistematik tregojnë se pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht në shëndetin mendor të shumë popullatave në shoqëri. Ankthi është i

përhapur brenda popullatës së përgjithshme, punonjësve të kujdesit shëndetësor, studentëve të universitetit dhe grupeve të tjera vulnerabël.

Halperin dhe kolegët (2021) raportuan se prevalenca e ankthit tek studentët e universitetit ishte 30.6%. [54].

Ekziston një bazë e gjerë e literaturës që ka treguar se ata që vuajnë nga shqetësimi psikologjik i lidhur me pandeminë priren të shfaqin nivele të larta të stresit post-traumatik, stresit të përgjithshëm, ankthit, ankthit shëndetësor dhe vetëvrasjes (Chong et al., 2004; Wheaton et al. ., 2012; Wu et al., 2009; Yip et al., 2010) të cilat mund të zgjasin edhe përtej rrjedhës së pandemisë.

Metodologjia

Natyra e punimit

Punimi është i natyrës empirike, analitiko-përshkruese, eksplorues dhe korrelues. Ai synon të interpretojë të dhënat e marra në rrugë empirike duke i përshkruar dhe analizuar ato nën përligjen e pyetjeve kërkimore të paraqitura. Punimi synon të verifikojë përmes eksplorimit gjendjen e prekjes së studentëve nga Covid-19, mënyrën e trajtimit ndaj tij dhe procedurën e vaksinimit të kampionit tonë. Gjithashtu interpretimet iu referohen variablave ankth dhe lokus kontrolli si elementë të përzgjedhur për të analizuar menaxhimin e situatës postcovid.

Për të realizuar më së miri pikësynimet kërkimore, punimi bazohet në një metodologji të larmishme në të cilën përfshihen frekuenca, përqindje, krostabulime, korrelime etj.

Kampioni

Pjesë e kampionit të këtij punimi janë studentë të degëve të Mësuesisë të Fakultetit të Shkencave të Edukimit në Universitetin e Shkodrës. Përzgjedhja e tyre është bërë në formën e censusit. Bazuar në të dhënat që disponon institucioni janë përfshirë mbi 70 % e studentëve që figurojnë të regjistruar. Gjithashtu ka një numër të vogël studentësh të cilët nuk janë llogaritur sepse pyetësorët e tjerë nuk kanë rezultuar të vlefshëm. Duke pasur parasysh se këtu janë përfshirë studentët aktivë e frekuentues të rregullt në mësimdhënie atëherë përqindja është edhe më e lartë. Përfshirë vetëm studentët e njërës degë (arsim parafillor) të cilët përbëjnë një % më të vogël për shkak se në kohën kur u përfshinë në plotësimin e instrumentit ishin në praktikë mësimore nëpër institucione.

Studentët janë ftuar të marrin pjesë në kampion pa shtërgime. Duhet theksuar se përmes dëshirës dhe vullnetarizmit të tyre janë përfshirë 85 studentë të cilët kanë plotësuar kriteret: janë studentë të nivelit Bachelor dhe janë studentë të degëve të Mësuesisë të Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Vetëm një numër shumë i vogël i studentëve kanë refuzuar të përfshihen.

Në këtë punim janë përfshirë disa degë të Fakultetit të Shkencave të Edukimit që lidhen më drejtëpërdrejtë me fushën e mësuesisë. Konkretisht janë përfshirë degët Cikël i Ulët, Edukatore, Pegagogji muzikore dhe Pikturë grafi.

Instrumenti i përdorur

Për të marrë të dhëna empirike është hartuar instrumenti i cili ndahet në tre pjesë. Në pjesën e parë përfshihen 4 pyetje me alternativa që kërkojnë informacion mbi prekjen nga covid-19, shkalla e prekjes, mënyrën e trajtimit të tij, herët e vaksinimit ndaj covid-19.

Pjesa e dytë përfshin inventarin e ankthit të Beck-ut, kurse pjesa e tretë e instrumentit paraqet shkallën e lokusit të kontrollit të Rotter-it. Instrumenti është përshtatur në gjuhën shqipe dhe ka kaluar fazën e pilotimit të tij.

Administrimi dhe mbledhja e të dhënave

Pyetësorët u administruan nga ne në bashkëpunim me studentë të degës Psikologji në universitetin e Shkodrës. Ato u plotësuan gjatë orës së seminareve ku pjesëmarrja e studentëve është e detyruar me rregullore. Kështu kishim mundësi të merrnim numrin sa më të madh të studentëve të rregullt për secilën degë që ishim të interesuar. Përpara plotësimit të tij studentët janë informuar për arsyet e mënyrën e plotësimit dhe iu është garantuar anonimati i dhënies së përgjigjes.

U është lënë kohë 15-20 minuta për plotësimin e tij individualisht. Nën mbikqyrjen tonë është ndjekur plotësimi i tij si dhe janë dhënë sqarime të mëtejshme në rast nevojë, edhe pse këto të fundit kanë qënë të izoluara.

Mbas plotësimit të instrumentit ai është dorëzuar dhe kështu është vepruar për dorëzimin të 85 instrumenteve. Mbas grumbullimit të 85 instrumenteve përgjigjet e tyre u koduan dhe nisi puna për hedhjen e të dhënave në programin Exel që do të mundësojë krijimin e bazës së të dhënave. Pas krijimit të bazës së të dhënave puna u fokusua në përpunimin e tyre sipas programit SPSS 26.

Rezultate dhe diskutime

Kanë rezultuar 85 studentë me përgjigje të vlefshme që i përkasin 4 degëve të Mësuesisë. Shpërndarja e kampionit sipas degëve të studimit paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela 1. Shpërndarja e kampionit sipas degëve të studimit

Degët	Frekuenca	Përqindja
Cikli i ulët (Arsim fillor)	30	35.3%
Arsim parashkollor	8	9.4%
Pedagogji muzikore	21	24.7%
Pikturë grafi	26	30.6%
Totali	85	100%

Nisur nga tabela 1 rezulton se shpërndarja në frekuenca dhe përqindje e kampionit tonë është e tillë: 30 studentë (35.3%) në degën Cikli i Ulët, 8 studentë (9.4%) në degën Arsimi parashkollor, 21 studentë (24.7%) në degën Pedagogji muzikore dhe 26 studentë (30.6%) në degën Pikturë grafi.

Tabela 2. Përvoja e kampionit me preken nga Covid-19

		Dega e Studimit				
		Cikli i Ulët	Arsim	Pedagogji	Pikturë	Total
		Arsim fillor	parashkollor	muzikore	grafi	
Cila është përvoja juaj personale me Covid:	Nuk jam prekur nga Covid	11	5	13	10	39
	Me ka prekur 1 herë	15	3	7	12	37
	Jam prekur me shumë se 1 herë	4	0	1	14	9
Total		30	8	21	26	85

Rezultate mbi preken nga covid-19

Nga tabela 2 rezulton se janë 39 studentë që nuk janë prekur nga covid-19 dhe 46 studentë që janë prekur nga covid-19.

Sipas degëve të studimit përvoja me covid-19 e kampionit tonë është e tillë:

Në degën Cikli i ulët nga 30 studentë që janë 11 studentë nuk kanë kaluar covid-19 dhe 19 studentë që janë prekur nga covid-19. Nga të prekurit janë 15 studentë që janë prekur 1 herë dhe vetëm 4 studentë të prekur më shumë se 1 herë.

Në degën Arsim parashkollor nga 8 studentë kemi 5 studentë që nuk janë prekur nga Covid-19 dhe 3 studentë që janë prekur 1 herë. Nuk rezultojnë studentë të prekur më shumë se një herë në këtë degë.

Në degën Pedagogji muzikore nga 21 studentë rezulton se kemi 13 studentë që nuk e kaluar covid-19, 7 studentë e kanë kaluar njëherë dhe vetëm 1 student që e ka kaluar më shumë se një herë.

Në degën Pikturë grafi nga 26 studentë rezultojnë 10 studentë të paprekur nga Covid-19, 12 studentë e kanë kaluar 1 herë dhe janë 4 studentë që janë prekur më shumë se një herë nga Covid-19.

Rezultate mbi mënyrën e trajtimit të covid-19

Tabela 3. Mënyra e trajtimit të covid-19 sipas degëve

		Dega e Studimit				Total
		Cikli i Ulët Arsim fillor	Arsim paras- hkollor	Pedagogji muzikore	Pikturë grafi	
Nëse keni qënë të prekur, trajtimin ndaj covid-it e keni bërë:	Në këmbë pa u izoluar e me mënyrën “popullorë”. Të izoluar në shtëpi me një kurë të lehtë sipas disa udhëzimeve nga ata që kishin njohje trajtimi të tillë. Të izoluar në shtëpi me një kurë tipike sipas rekomandimit të mjekut.	6 8 5	0 2 1	4 3 4	8 6 5	18 19 15
Total		19	3	11	19	52

Tabela 3 tregon se 18 studentë e prekur nga covid-19, e kanë trajtuar atë në këmbë me një përkujdesje “popullore”, 19 studentë e kanë trajtuar duke u izoluar dhe sipas këshillave jo mjekësore por të vujatësve ndaj tij, dhe 15 studentë e kanë trajtuar duke u izoluar sipas kurës së rekomanduar nga mjeku. Nuk rezultojnë studentë që e ka trajtuar covid-19 në kushte spitalore.

Nëse do të shikojmë trajtimin sipas degëve tabela tregon se kemi një shpërndarje në të tre variantet e trajtimit të paraqitura. Dega pikturë grafi ka frekuencë më të madhe në trajtimin “popullor” (N=8), kurse dega Cikli i ulët e ka në trajtimin izolim sipas këshillave jo mjekësore por të vujatësve ndaj tij. Dega Pedagogji muzikore ka një shpërndarje thuajse të njëjtë, kurse dega Arsim parashkollor nuk ka studentë në opcionin trajtim “popullor”.

Rezultate mbi vaksinimin

Tabela 4. Krostabulimi vaksinimi * degë studimi

		Dega e Studimit				Total
		Cikli i Ulët Arsim fillor	Arsim parash- kollor	Pedagogji muzikore	Pikturë grafi	
Në mbrojtje ndaj covid-it sa herë ju jeni vaksinuar:	1 pavaksinuar	9	2	6	13	30
	Vaksinuar 1 here	7	0	1	1	9
	Vaksinuar 2 here	13	6	11	11	41
	Vaksinuar 3 here	1	0	3	1	5
Total		30	8	21	26	85

Rezultoni se janë 30 studentë (35.3%) që nuk janë vaksinuar dhe 55 studentë (64.7 %) e tyre që janë vaksinuar.

Nga 55 studentë të vaksinuar rezultojnë 9 studentë të vaksinuar 1 herë. Pjesa më e madhe e kanë bërë vaksinën 2 herë (N=41). Duke shtuar edhe 5 studentët që janë vaksinuar 3 herë atëherë themi se studentët e kanë ndjekur procedurën e vaksinimit me rregull të paktën në 55% të totalit të kampionit.

Rezultate mbi nivelin e ankthit

Tabela 5. Krostabulimi nivele ankthi * Dega e Studimit

Count		Dega e Studimit				Total
		Cikli i Ulët	Arsim Parashkollor	Pedagogji	Pikturë grafi	
		Arsim Fillor		muzikore		
Nivelet e	Jo ankth	14	4	15	17	50
ankthit	Ankth i ulët	10	3	5	7	25
	Ankth i lartë	6	1	1	2	10
Total		30	8	21	26	85

Nga tabela 5 rezulton se nga 85 studentë të kampionit kemi 50 studentë me nivelin jo ankth, 25 studentë me ankth të ulët dhe vetëm 10 studentë me nivel të lartë ankthi. Shikojmë se 59% e studentëve të kampionit gjenden në nivelin jo ankth (N=50).

Sipas degëve të studimit shpërndarja në nivelet e ankthit është: dega Cikli i Ulët 14 studentë jo ankth, 10 studentë ankth i ulët dhe 6 studentë me ankth të lartë; dega Arsimit parashkollor 4 studentë me nivel jo ankth, 3 studentë me nivel ankth i ulët dhe 1 student me ankth të lartë; dega Pedagogji muzikore ka 15 studentë me jo ankth, 5 studentë me ankth të ulët dhe 1 student me ankth të lartë; dega Pikturë grafi ka 17 studentë me jo ankth, 7 studentë me ankth të ulët dhe 2 studentë në nivelin ankth i lartë. Në të gjitha degët e përfshira në kampion frekuenca më e lartë gjendet në nivelin jo ankth.

Rezultate mbi lokusin e kontrollit

Tabela 6. Shpërndarja e kampionit sipas krostabulimit Lloji lokusit * Dega e Studimit

		Dega e Studimit				Total
		Cikli i Ulet	Arsim Paras-	Pedagogji	Pikturë grafi	
		Arsim fillor	hkollor	Muzikore		
Lloji lokusit	LKB	5	3	8	12	28
	LKJ	25	5	13	14	57
Total		30	8	21	26	85

Tabela 6 tregon se janë 28 studentë me prirje lokusi kontrolli të brendshëm (LKB) dhe 57 studentë me lokus kontrolli të jashtëm (LKJ). Shpërndarjen më të lartë e gjejmë në degën Ckli i ulët duke tregohet qartë diferenca mes llojeve të lokusit. Vetëm dega Pikturë grafi e ka shpërndarje thuajse të njëjtë. Edhe në degët e tjera prirja për lokus kontrolli të jashtëm (LKJ).

Konkretisht shpërndarja e kampionit rezulton: dega Cikli i ulët 5 studentë me LKB dhe 25 studentë me LKJ; dega Arsim parashkollor 3 studentë me LKB dhe 5 studentë me LKJ; dega Pedagogji muzikore 8 studentë me LKB dhe 13 studentë me LKJ; dega Pikturë grafi

Mbi lidhjen nivel ankthi & vaksinim

Tabela 7. Korrelimi ankth& vaksinim

		Nivelet e ankthit	Në mbrojtje ndaj covid-it sa herë ju jeni vaksinuar:
Nivelet e ankthit	Pearson Correlation	1	.149
	Sig. (2-tailed)		.172
	N	85	85
Në mbrojtje ndaj covid-it sa herë ju jeni vaksinuar:	Pearson Correlation	.149	1
	Sig. (2-tailed)	.172	
	N	85	85

Ka korrelim shumë të vogël pozitiv (0.149) i cili mbetet për tu analizuar më tej për rëndësinë statistikore të tij.

Mbi lidhjen lokus kontrolli & mënyrë trajtimi të covid-19

Tabela nr 8. Lloji lokusit * Nëse keni qënë të prekur, trajtimin ndaj covid-it është bërë:

		Nëse keni qënë të prekur, trajtimin ndaj covid-it e keni bërë:			Total
Në këmbë pa u izoluar e me mënyrën "popullorshë".		Të izoluar në shtëpi me një kurë të lehtë sipas disa udhëzimeve nga ata që kishin njohje trajtimi të tillë.	Të izoluar në shtëpi me një kurë tipike sipas rekomandimit të mjekut.	Krostabulimi nivele ankthi * Dega e Studimit	
Lloji	LKB	11	5	5	21
lokusit	LKJ	7	14	10	31
Total		18	19	15	52

Siç shikohet edhe nga tabela e mësipërme nga 52 studentë që janë kanë trajtuar situatën covid-in rezulton se 18 studentë e kanë trajtuar në izolim në këmbë, 19 studentë në izolim sipas udhëzimeve të referuesve dhe 15 të izoluar në shtëpi sipas rekomandimit të mjekut.

Përfundime

Ndalemi tek **përfundimet** e rezultateve të paraqitura të cilat do i bazojmë në pyetjet kërkimore që kemi paraqitur.

1. Si shfaqet prekja nga covid-19 tek studentët e kampionit tonë?

Nisur nga sa u pa, theksojmë se studentët e përfshirë në kampionin tonë, kanë një prekje mbi 50% nga covid-19. Ka një numër relativisht të lartë të paprekurish me covid-19, edhe pse bëhet fjalë për një periudhë mbi një vit që pandemia është përhapur si fenomen botëror.

Vetëm një numër i vogël i të prekurve (pak mbi 10%) është prekur më shumë se një herë. Mundet të themi se prekshëmëria tek kampioni ynë shfaqet në nivele jo shumë të larta.

2. Cila është mënyra e trajtimit të bërë nga prekja e covid-19?

Nga individët e prekur doli se rreth 70% e studentëve kanë ndjekur metoda jo mjekësore trajtimi shëndetësor. Vetëm 30% e të prekurve kanë marrë trajtim rekomandues mjekësor. Shumë studentë nuk ose kanë pasur prekje të lehtë, ose e kanë trajtuar pa rënë në sy covid-19 ose kanë neglizhuar rigorizitetin e trajtimit.

3. Cila është situata e vaksinimit tek studentët e kampionit tonë?

Rreth 65 % e studentëve janë vaksinuar disa më shumë se një herë. Verifikohet vaksinim i tyre edhe nga studentë të cilët nuk janë prekur nga covid-19. Kjo na bën të themi se përkujdesja e mbrojtjes ndaj covid-19 ka qenë në nivel të mirë e të duhur.

4. Si shfaqen variablat ankth dhe lokus kontrolli?

Studentë kanë nivele jo problemore ankthi. Përrjashtim bëjnë diku 12-13% e tyre të cilët mbetën në nivele ku ankthi është shqetësues mbi normalitetin që duhet të ketë një individ në situata pandemie. Pjesa më e madhe tregon se tashmë situatën e kontrollojnë pa shqetësime alarmuese ankthi ose shfaqen në nivele jo ankth në sensin që shqetësimi i tyre ndaj covid-19 është nën kontroll.

Vetëm 1/3 e studentëve kanë prirje lokusi kontrolli të brendshëm. Pjesa tjetër (2/3 e tyre) ka lokus kontrolli të jashtëm. Mbase moshë e tyre, pra të qenurit ende pa përballje personale me sfidat e kërkesave të jetës, i mban ata ende me prirje drejt ndodhive, rastësisë dhe fatit.

5. A ndikojnë nivelet e ankthit në herët e vaksinimit?

Nivelet e ankthit duket se ndikojnë dobët ose aspak në herët e vaksinimit. Këtë e tregon jo vetëm koeficienti i vogël (0.149) por edhe fakti se ka tregues që edhe ata të pa prekur nga covid janë vaksinuar.

6. A ka lidhje lokusi me mënyrën e trajtimit të covid-19?

Ka diferenca të vogla mes të qenurit me LKB apo LKJ në mënyrëbn e trajtimit nga prekja me covid-19. Ata me LKB kanë prirje ta trajtonë kurën me metoda tradicionale, kurse ata me LKJ shfaqen të prirur të përdorin trajtimin sipas rekomandimeve apo edhe mjekut. Megjithatë mbetet për tu parë nëse këto dallime kanë rëndësi statistikore.

Mund të themi se studentët e kampionit tonë, e kanë situatën nën kontroll ndaj covid-19, ndjekin procedure mbrojtëse në nivelin e duhur dhe nuk konsiderohen të alarmuar në trajtimin e tij.

Referenca

1. APA diactionay of Psychology. Revised edition of APA dictionary of psychology 2007. ISBN 978-1-4338-1944-5 -- ISBN 1-4338-1944-9 1.
2. Alshekaili, M.; Hassan, W.; Al Said, N.; Al Sulaimani, F.; Jayapal, S.K.; Al-Mawali, A.; Chan, M.F.; Mahadevan, S.; Al-Adawi, S. Factors associated with mental health outcomes across health-care settings in Oman during COVID-19: Frontline versus non-frontline healthcare workers. *BMJ Open* **2020**, *10*, e042030.
3. Di Blasi, M.; Gullo, S.; Mancinelli, E.; Freda, M.F.; Esposito, G.; Gelo, O.C.G.; Lagetto, G.; Giordano, C.; Mazzeschi, C.; Pazzagli, C.; et al. Psychological distress associated with the COVID-19 lockdown: A two-wave network analysis. *J. Affect. Disord.* **2021**, *284*, 18-26.
4. Gundogmus, I.; Unsal, C.; Bolu, A.; Takmaz, T.; Okten, S.B.; Aydin, M.B.; Ucar, H.; Gunduz, A.; Kul, A.T. The comparison of anxiety, depression and stress symptoms levels of healthcare workers between the first and second COVID-19 peaks. *Psychiatry Res.* 2021, *301*, 113976.
5. Hoti, V & Hoti, A. (2021). “Hyrje në psikologji - botim i dytë”. Botime “Enja”, Tiranë. ISBN 978-9928-358-63-9.
6. Jacques-Avino, C.; Lopez-Jimenez, T.; Medina-Perucha, L.; de Bont, J.; Goncalves, A.Q.; Duarte-Salles, T.; Berenguera, A. Gender- based approach on the social impact and mental health in Spain during COVID-19 lockdown: A cross-sectional study. *BMJ Open* 2020, *10*, e044617.
7. Jiang, W.; Liu, X.; Zhang, J.; Feng, Z. Mental health status of Chinese residents during the COVID-19 epidemic. *BMC Psychiatry* **2020**, *20*, 580. [CrossRef]
8. Li, H.Y.; Cao, H.; Leung, D.Y.; Mak, Y.W. The psychological impacts of a COVID-19 outbreak on college students in China: A longitudinal study. *Int. J. Environ. Res. Public Health* 2020, *17*, 3933.
9. Cao, W.; Fang, Z.; Hou, G.; Han, M.; Xu, X.; Dong, J.; Zheng, J. The psychological impact of the COVID-19 epidemic on college students in China. *Psychiatry Res.* 2020, *287*, 112934.
10. Cheng, C.; Cheung, S.F.; Chio, J.H.M.; Chan, M.P.S. Cultural meaning of perceived control: A meta-analysis of locus of control and psychological symptoms across 18 cultural regions. *Psychol. Bull.* 2013, *139*, 152.
11. Wallston, B.S.; Wallston, K.A.; Kaplan, G.D.; Maides, S.A. Development and validation of the health locus of control (HLC) scale. *J. Consult. Clin. Psychol.* 1976, *44*, 580-585.
12. Kesavayuth, D.; Poyago-Theotoky, J.; Zikos, V. Locus of control, health and healthcare utilization. *Econ. Model.* 2020, *86*, 227-238.
13. Levenson, H. Multidimensional locus of control in psychiatric patients. *J. Consult. Clin. Psychol.* 1973, *41*, 397-404.